



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:200403

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760152

KPPP.nr.1507/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Pharma Plus” me numër unik identifikues 810535429 me seli në Prishtinë me adresë në Rr.’’Rexhep Krasniqi’’ Lam.A, Bll.C2, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Asman Hoxha, kundër debitorit “Adisa Pharma” SHPK me numër unik identifikues 811573428 me seli në Prizren me adresë në Rr.’’Remzi Ademaj’’ Nr.91 duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.228/23 të datës 21.08.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.05.2024 mori këtë:

**AKTVENDIM**

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Adisa Pharma” SHPK me numër unik identifikues 811573428 me seli në Prizren me adresë në Rr.’’Remzi Ademaj’’ Nr.91 ashtu që Urdhri P.nr. 228/23 të datës 21.08.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr. 228/23 të datës 21.08.2023, të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.1164-210-001-23, e datës 26.01.2023, faturës më nr.1165-210-001-

23, e datës 26.01.2023, faturës me nr.1401-210-001-23, e datës 31.01.2023 dhe faturës me nr.1754-210-001-23 e datës 07.02.2023, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrit t'i paguajë kreditorit borxhit 1,064.42 Euro, me kamatë vonesë prej 8% nga data e arritjes së afatit për pagesë të secilës faturë të pa paguar e de ri në pagesën definitive, përpilimin e propozimit në shumën prej 104 eurove si dhe shpenzimet e procedurës përmabrimore në total nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbarruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumentet në bazë të të cilave është marrë urdhri përmbarrues nuk janë të përshtatshme për përmbarrim dhe nuk janë dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar. Më tej ka theksuar se në tërësi e kundërshton përmbarrimin sepse i njëjti i ka paguar faturat ku si dëshmi ka bashkëngjitur edhe dëftesat për të vërtetuar përmbushjen e obligimit në tërësi ndaj kreditorit për mallrat e pranuar.

I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin për përmbarrim P.nr.228/23 të datës 21.08.2023

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit ngase i njëjti është i pabazuar për faktin se faturat në bazë të të cilave është iniciuar proceduar e përmbarrimit janë të kontrolluara, nënshkruara dhe pranuar nga debitori e si rrjedhojë parashtrimi i së njëjti nënkupton vetëm qëllimin e prolongimit të procedurës përmabrimore. Lidhur me pretendimet e debitorit se i njëjti ka kryer pagesat për mallin e pranuar, kreditori ka theksuar se dëftesat e bashkëngjitura në shkresat e lëndës janë pagesa të kryera në vitin 2022 e që nuk ndërlidhen aspak me faturat të cilat janë objekt përmbarrimi.

I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Adisa Pharma” SHPK ndërsa Urdhri Përmbarrues P.nr.228/23 të datës 21.08.2023 të mbetet ne fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe

*se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.*

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme: faturën nr.1164-210-001-23, e datës 26.01.2023, faturës më nr.1165-210-001-23, e datës 26.01.2023, faturën me nr.1401-210-001-23, e datës 31.01.2023 dhe faturën me nr.1754-210-001-23 e datës 07.02.2023 në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e debitorit se i njëjti e ka përmbushur në tërësi detyrimin ndaj kreditorit për faktin se ka bashkëngjitur edhe dëftesa që dëshmojnë përmbushjen e detyrimit mirëpo ka vlerësuar se në asnjërën nga këto dëftesa nuk është e përshkruar dhe dëshmuar dhe as saktësuar se për cilën faturë bëhet fjalë, gjegjësisht për cilën faturë është kryer pagesa për shërbimet e marra nga kreditori.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1507/23, me datë 29.05.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.